

Kompania Rajonale E Ujësjesit
GJAKOVA SH.A.
Gjakovë

**Raporti i Auditorëve të Pavarur
dhe Pasqyrat Financiare**

**Për vitin kalendarik që përfundon
me 31 Dhjetor 2023**

Përmbajtja	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	2-4
Deklarata e Pajtueshmerisë	5
Pasqyra e Pozitës Financiare	6
Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	7
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet	8
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	9
Shënime mbi Pasqyrat Financiare	10-23

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e K.R.U. GJAKOVA SH.A.

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të K.R.U. GJAKOVA SH.A. (tutje i referohemi Kompania) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datë 31 Dhjetor 2023, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe shënimet në pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes të përshkruara në paragrafin Baza për Opinion të kualifikuar, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë me datën 31 Dhjetor 2023, dhe rezultatin e saj financiar dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të kualifikuar

- Lidhur me pozicionin e Llogarive të Arkëtueshme në pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2023 :
 - Siç është shpjeguar në shënimin 2, Llogaritë e arkëtueshme tregtare me vlerë prej 5,976,696 euro për vitin 2022 dhe 5,567,632 euro për vitin 2023 . Provizionimi i tyre për këtë periudhë është bërë në mënyrë lineare me 1% pa ndonjë llogaritje në mungesë të perpunitimit softverik për klasifikimin sipas vjetërsisë. Sipas SNRF 9 kërkohet që në çdo datë raportimi kompania të masë provizionin për humbjen e një instrumenti financiar në atë shumë të barabartë me humbjen e pritshme përgjatë gjithë jetës se tij nese rreziku i tij është shtuar ndjeshëm që nga njohja fillestare.
 - Bazuar në evidencën kontabel të kompanisë një numer i konsiderueshëm i Llogarive të arkëtueshme janë të bartura me gjendje si parapagime në vlerë mbi 100 mijë euro, me siguri kjo edhe për shkak të mosbarazimeve me gjendjet e këtyre klientëve ku në mesin e tyre ka edhe blerës të paidentifikuar.
- Siç është paraqitur në shënimin 3, Inventari dhe materiali tjetër në përdorim i cili është jofunksional pasi që prej tyre nuk pritet dobi ekonomike në të ardhmen për kompaninë ashtu siç e trajton edhe SNK 16 paragrafi 67 ku ndër të tjera thuhet së Vlera kontabël (neto) e një zëri të aktiveve materiale nuk do të njihet kur nuk priten më përfitime ekonomike në të ardhmen nga përdorimi i tij ose shitja.
- Siç është shpalosur në shënimin 1 Prona ,Impianet dhe Pajisjet që në pasqyrën e pozitës financiare janë prezentuar në vlerë prej 55,795,812 Euro , rivlerësimi i fundit është kryer në vitin 2020, kur dihet se në tri vitet e fundit ka pasur devalvim të theksuar të valutës që përdoret në vend (Euro). Lidhur me këtë, SNK 16 paragrafi 31 ndër të tjera thëkson së Rivlerësimet do të bëhen në mënyrë të rregullt të mjaftueshme që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në datën e bilancit.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin BSNEK. Ne besojmë se evidencia e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinion të kualifikuar.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiarë (SNRF), dhe për kontrollet e brendshme, në masën që përcaktohet nga menaxhmenti, është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likuideojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku I mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruar, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Kompanisë. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Kompania të ndërpres veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Kompanisë përveç të tjerash, edhe përfshirë primarin e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme të kontrollit të brendshëm që ne kemi identifikuar gjatë auditimit.

Raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullative

Opinion mbi Raportin e Menaxhmentit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të K.R.U. GJAKOVA SH.A. si dhe informacionin e shkruar në raportin e menaxhmentit bazuar në kërkesat ligjore të përcaktuara në *Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 10*.

Sipas opinionit tonë raporti i menaxhmentit është në përputhje me pasqyrat financiare për vitin financiar raportues si dhe është përgatitur në përputhje me kërkesat e *Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, neni 10, dhe UA Nr.02/2019 për pavarësinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit*.

Raport mbi kërkesat tjera

- Ne jemi angazhuar si auditor të K.R.U. GJAKOVA SH.A. për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, më datë 21.12.2022 nga menaxhmenti i kompanisë.
- Ne kemi vlerësuar rreziqet më të rëndësishme të anomalive materiale, duke përfshirë rreziqet e vlerësuara të anomalive materiale për shkak të mashtrimit, si më poshtë:
Jetëgjatësia e dobishme e aseteve; Dëmtimi i mundshëm i pajisjeve dhe Vlerësimi i llogarive te arketueshme.
- Ne kemi dizajnuar procedurat e auditimit në mënyrë që t'iu përgjigjemi rreziqeve të identifikuar për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshmet dhe për të fituar siguri të arsyeshme lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese.
- Ne deklarojmë që nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo audituese të përmendura në *UA nr.02/2019 për pavarësinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit, Neni 5* dhe ne jemi të pavarur ndaj subjektit të audituar gjatë kryerjes së auditimit;

“ Audit Check ” SH.P.K.

Haxhi Nimanaj
Partner Angazhimi
04 Prill 2024



KRU GJAKOVA SH.A.

Deklaratë e Pajtueshmërisë për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31 Dhjetor 2023

Emri i Kompanisë: K.R.U. GJAKOVA SH.A.

Numri Unik Identifikues: 811292086


Adresa: Gjakovë, U.Ç.K. nr.7

Deklaratë e Pajtueshmërisë

-Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31.12.2023-

Deklaroj që pasqyrat financiare për vitin raportues 2023 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e *Ligjit 06/L- 032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim*.

Kryeshf Ekzekutiv


Hasan Krasniqi



U.D. Zyrtare Kryesore Financiare


Sihana Asllani

Gjakovë, Shkurt 2024

KRU GJAKOVA SH.A.**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023****RAPORTI FINANCIAR VJETOR****PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

		2023	2022
	Shënime		
PASURIA			
Pasuria Jo-qarkulluese			
Toka, Ndërtesa, Automjetet dhe Paisjet	1	55,780,207	41,004,814
Investimet në vijim	1	695,160	8,257,560
Total pasuria jo qarkulluse (I)		56,475,366	49,262,374
Pasuria qarkulluese			
Të arkëtushmet tregtare dhe tjera	2	5,567,632	5,976,696
Stoqet	3	735,935	682,161
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	1,177,331	1,502,335
Total pasuria qarkulluese (II)		7,480,898	8,161,193
Total Pasuria (I+II)		63,956,264	57,423,567
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali			
Kapitali Aksionar	5	25,000	25,000
Fitimi (humbja) e mbajtur	6	(745,779)	(479,715)
Rezerva e Rivlerësimit dhe tjerat	7	40,910,964	41,043,598
Total kapitali (III)		40,190,185	40,588,884
Detyrimet afatgjata			
Kreditë afatgjata			
Total detyrimet afatgjata (IV)		0	0
Detyrimet afatshkurta			
Kreditë afatshkurta			
Llogaritë e Pagueshme tregtare dhe tjera	8	204,322	271,027
Detyrime ndaj punëtorëve dhe tatime	9	71,824	86,677
Të hyrat e shtyra	10	23,489,933	16,476,979
Total detyrimet afatshkurta (V)		23,766,079	16,834,683
Total Detyrimet dhe Kapitali (III+IV+V)		63,956,264	57,423,567

Kryeshef Ekzekutiv

Hasan Krasniqi

U.D. Zyrtare Kryesore Financiare

Sihana Asllani

Kontabilisti I Çertifikuar

Vedat Beqiri

KRU GJAKOVA SH.A.**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023****PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE**

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

		2023	2022
	<i>Shënime</i>		
Të hyrat			
Të hyrat	11	5,923,977	5,629,725
Gjithsej të hyrat		5,923,977	5,629,725
Shpenzimet			
Shpenzimet e personelit	12	(2,734,904)	(2,597,646)
Shpenzimet operative dhe administrative	13	(1,477,223)	(1,465,411)
Shpenzimet e Zhvlerësimit	14	(1,977,915)	(1,855,204)
Gjithsej shpenzimet		(6,190,042)	(5,918,261)
Fitimi (humbja) nga aktivitetet operative		(266,064)	(288,536)
Fitimi (humbja) financiare			
Shpenzimet Financiare			
Gjithsej fitimi (humbja) financiare			
Fitimi (humbja) para tatimit		(266,064)	(288,536)
Tatimi në fitim			
Fitimi (humbja) neto e vitit		(266,064)	(288,536)

Kryeshef Ekzekutiv

Hasan Krasniqi

U.D. Zyrtare Kryesore Financiare

Sihana Asllani

Kontabilisti i Çertifikuar

Vedat Beqiri

KRU GJAKOVA SH.A.**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023****PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET**

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

	Kapitali investus	Fitimi (humbja) e mbajtur	Rezerva të Rivleresimit	Gjithsej
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	25,000	(121,988)	31,573,655	31,476,667
Shtim	0	0	0	0
Rregullimet në fitimin e mbajtur	0	0	0	0
Fitimi (humbja) e vitit	0	140,493	0	140,493
Gjendja me 31 Dhjetor 2018	25,000	18,505	31,573,655	31,617,159
Shtim	0	0	0	0
Rregullimet në fitimin e mbajtur	0	(163,531)	180	(163,351)
Fitimi (humbja) e vitit	0	112,602	0	112,602
Gjendja me 31 Dhjetor 2019	25,000	(32,424)	31,573,835	31,566,411
Shtim	0	0	10,979,493	10,979,493
Rregullimet në fitimin e mbajtur	0	(15,769)	0	(15,769)
Fitimi (humbja) e vitit	0	(492,586)	0	(492,586)
Gjendja me 31 Dhjetor 2020	25,000	(540,779)	42,553,327	42,037,548
Shtim	0	0	(2,871)	(2,871)
Rregullimet në fitimin e mbajtur	0	431,386	(946,375)	(514,989)
Fitimi (humbja) e vitit	0	(58,397)	0	(58,397)
Gjendja me 31 Dhjetor 2021	25,000	(167,791)	41,604,082	41,461,291
Shtim	0	0	0	0
Rregullimet në fitimin e mbajtur	0	(23,388)	(560,484)	(583,872)
Fitimi (humbja) e vitit	0	(288,536)	0	(288,536)
Gjendja me 31 Dhjetor 2022	25,000	(479,715)	41,043,598	40,588,883
Shtim	0	0	0	0
Rregullimet në fitimin e mbajtur	0	0	(132,634)	(132,634)
Fitimi (humbja) e vitit	0	(266,064)	0	(266,064)
Gjendja me 31 Dhjetor 2023	25,000	(745,779)	40,910,964	40,190,185

KRU GJAKOVA SH.A.**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023****PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË**

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023

	2023	2022
I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi (humbja) e vitit	(266,064)	(288,536)
<i>Të korrigjuara për:</i>		
Zhvlerësimi	1,977,915	1,855,204
Rregullimet në Zhvlersimin e Akumuluar	(10,092)	
Provizionet e borxheve te keqija	0	0
Rregullime në fitime të mbajtura	(132,634)	(583,871)
(Rritja)/zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera	409,064	356,421
Rritja/(zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera	(66,705)	(35,933)
Rritja/(zvogëlimi) në detyrimet ndaj punëtorëve dhe tatimeve	(14,853)	23,963
Rritja/(zvogëlimi) në të hyrat e shtyra	7,012,954	493,567
(Rritja)/zvogëlimi në parapagime		
(Rritja)/zvogëlimi në stoqe	(53,773)	(19,233)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative	8,855,811	1,801,581
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative (I)	8,855,811	1,801,581
II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerjet e pronës, impianteve dhe pajisjeve	(9,180,815)	(1,782,365)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese (II)	(9,180,815)	(1,782,365)
III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Huamarrjet	0	0
Arkëtimet nga donacione	0	0
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese (III)	0	0
IV. Rritja neto në para dhe ekuivalente (I + II + III)	(325,005)	19,216
V. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit/periudhës	1,502,335	1,483,119
VI. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit/periudhës (IV + V)	1,177,330	1,502,335

KRU GJAKOVA SH.A.

Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

I. Informata të përgjithshme

Kompania Regjionale e Ujit "Gjakova" Sh. A, Gjakove, me tutje "Kompania" është shoqëri aksionare e inkorporuar me 29 Maj 2007 në Kosovë, sipas Projektit për Korporatizimin e Sektorit të Ujit në Kosovë. Kompania është themeluar tërësisht nga Kompanitë Regjionale të Ujit, si dhe duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/6 mbi shoqëritë tregtare dhe Ndërmarrjet afariste "Radoniqi" Holding SH.A. dhe është pasardhëse legale e Kompanisë Publike "Radoniqi", Gjakove. Adresa e zyrës qendrore të regjistruar është në rrugën UCK 7, Gjakovë, Kosovë.

Kompania është themeluar në pajtim me Ligjin mbi Shoqëritë Tregtare 02/L-123 me Numër Unik Identifikues 811292086.

Kapitali fillestar i regjistruar i Kompanisë është 25,000 Euro. Librat e Kompanisë janë hapur me 01 Janar 2007 bazuar në Pasqyrën e Gjendjes Fillestare, pastaj Raporti i Studimit Financiar po ashtu edhe të dhënat nga vlerësimi i bërë me 01 Janar 2008 nga Konzorciumi Curtis, Mallet- Prevost, Colt & Mosle LLP USA New York dhe Grant Thornton Consulting DOO Maqedonia – Shkup ("Konzorciumi").

Aktiviteti kryesorë i Kompanisë është grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë kodi 3600. Adresa e Kompanisë: Rr. UÇK Nr.7, Gjakovë.

II. ADOPTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË REJA DHE ATYRE TË RISHIKUARA PËR RAPORTIM FINANCIAR

Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën e raportuar

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare janë në fuqi për periudhën raportuese (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2023):

- **Ndryshimet në SNK 1 Klasifikimin e Detyrimeve si afatshkurta ose afatgjata**
Më 23 Janar 2020, BSNK lëshoi 'Klasifikimin e Detyrimeve si afatshkurta ose afatgjata (ndryshimet në SNK 1)' duke siguruar një qasje më të përgjithshme për klasifikimin e detyrimeve sipas SNK 1 bazuar në marrëveshjet kontraktuale në vend në datën e raportimit. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022, megjithatë, data e tyre efektive është shtyer në 1 janar 2023.
- **Ndryshimet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit**
Më 25 Qershor 2020, BSNK lëshoi 'Ndryshime në SNRF 17' për të adresuar shqetësimet dhe sfidat e zbatimit që u identifikuan pasi SNRF 17 'Kontratat e Sigurimit' u publikua në 2017. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023.
- **Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës së SNRF 2**
Më 12 Shkurt 2021, BSNK publikoi "Shpalosja e Politikave Kontabël" me ndryshime që synojnë të ndihmojnë përgatitësit të vendosin se cilat politika kontabël duhet të shpalosin në pasqyrat e tyre financiare. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2023.

KRU GJAKOVA SH.A.

Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

- **Ndryshime në SNK 8 - Vlerësimet Kontabël**

Më 12 Shkurt 2021, BSNK publikoi 'Përkufizimin e Vlerësimeve Kontabël' për të ndihmuar njësitë ekonomike të bëjnë dallimin midis politikave kontabël dhe vlerësimeve kontabël. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2023.

- **Ndryshimet në SNK 12 – Tatimi i Shtyrë**

Më 7 Maj 2021, BSNK publikoi 'Tatimi i Shtyrë në lidhje me Asetet dhe Detyrimet që rrjedhin nga Një Transaksion i Vetëm' që sqaron se si kompanitë llogarisin tatimin e shtyrë për transaksione të tilla si qiratë dhe detyrimet e nxjerrjes jashtë përdorimit. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2023.

Standardet dhe interpretimet në fjalë nuk janë ende efektive

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare të veçanta standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma në fuqi.

- **Ndryshimet në SNRF 16 - Qiratë**

Më 22 shtator 2022, BSNK publikoi 'Detyrimin e qirasë në një shitje dhe kthim me qira' me ndryshime që sqarojnë se si shitësi-qiramarrësi më pas mat transaksionet e shitjes dhe të kthimit me qira që plotësojnë kërkesat në SNRF 15 për t'u kontabilizuar si një sallë. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024.

- **Ndryshime në SNK 1**

Më 31 tetor 2022, BSNK publikoi 'Detyrime afatgjata me Marrëveshje' për të sqaruar se si kushtet me të cilat një njësi ekonomike duhet të pajtohet brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës raportuese ndikojnë në klasifikimin e një pasivi. Ndryshimet janë efektive për periudhat raportuese që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024.

- **Ndryshimet në SNK 7**

Pasqyra e rrjedhjes së parave dhe SNRF 7 Instrumente Financiare: Shpalosjet: Marrëveshjet financiare të furnizuesit (të zbatueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024, por ende nuk janë miratuar në BE).

- **Ndryshimet në SNK 21**

Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor: Mungesa e shkëmbimit (zbatohet për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2025, por ende nuk janë miratuar në BE).

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretime ekzistuese nuk kanë ndikuar në politikat kontabël të Kompanisë.

KRU GJAKOVA SH.A.

Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

III. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Bazat e përgatitjes dhe politikat kontabël

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Raportimit Financiar ("SNRF") të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF të miratuara kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kritike kontabël. Ai gjithashtu kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të kompanisë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë shpalosur në shënimin IV.

Baza e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në baza historike të kostos përveç rivlerësimit të pasurisë së caktuar për asete dhe detyrime të caktuara që janë vlerësuar me vlerën reale.

Monedha funksionale dhe raportuese

Monedha funksionale e Kompanisë është monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon njësisia ekonomike.

Pasqyrat Financiare janë paraqitur në njësi monetare Euro (€), e cila është edhe monedha funksionale për Kompaninë. Euro (€) është valuta kombetare në Kosovë.

Konvertimi i valutës së huaj.

Transaksionet në valutë të huaj janë transaksione të ndërmarra nga Kompania në një monedhë të ndryshme nga monedha e saj funksionale. Transaksionet në valutë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit valutor në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare të shprehura në valuta të huaja përkthehen në Euro me kursin e këmbimit valutor në datën e raportimit. Diferencat e këmbimit valutor që lindin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje. Asetet dhe detyrimet jo-monetare që maten në terma të kostos historike në monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Instrumentet financiare - njohja fillestare. Instrumentet financiare në VDPFH (vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes) regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë. Të gjitha instrumentet e tjera financiare regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare evidentohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje nga njohja fillestare regjistrohet vetëm nëse ka një diferencë midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit, i cili mund të evidentohet nga transaksione të tjera aktuale të vëzhgueshme të tregut në të njëjtin instrument ose nga një teknikë vlerësimi, inputet e së cilës përfshijnë vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme. Pas njohjes fillestare, një lejim HPK njihet për asetet financiare të matura me KA dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me VDPATGJ (vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Të gjitha blerjet dhe shitjet e aseteve financiare që kërkojnë dorëzim brenda kornizës kohore të përcaktuar nga rregullorja ose konventa e tregut (blerjet dhe shitjet "mënyrë e rregullt") regjistrohen në datën e tregtimit, që është data në të cilën Kompania angazhohet të dorëzojë një aset financiar. Të gjitha blerjet e tjera njihen kur entiteti bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë. Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankë dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturime fillestare prej tre muajsh ose më pak.

KRU GJAKOVA SH.A.

Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera. Të arkëtueshmet tregtare janë regjistruar fillimisht me shumën e arkëtuar kundrejt shitjes së produkteve. Më pas të arkëtueshmet tregtare janë dhënë në koston nominale minus lejimi për borxhet e dyshimta.

Të pagueshme tregtare dhe të tjera. Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutor janë të përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

Tatimi mbi vlerën e shtuar. Tatimi mbi vlerën e shtuar i ngarkuar në lidhje me shitjet i paguhet autoriteteve tatimore kur cilado që ndodhë më parë: (a) mbledhja e të arkëtueshmeve nga klientët ose (b) dërgimin e mallrave ose shërbimeve të klientët. TVSH-ja e mledhur në përgjithësi është e rikuperueshme kundrejt TVSH-së së ngarkuar pas marrjes së faturës së TVSH-së. Autoritetet tatimore lejojnë shlyerjen e TVSH-së mbi bazën neto. TVSH-ja e lidhur me shitjet dhe blerjet njihet në pasqyrën e pozicionit financiar në bazë bruto dhe shpaloset veçmas si një aset dhe detyrim.

Parapagimet. Parapagimet mbahen me kosto minus provizionet për dëmtim. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet në lidhje me parapagimin pritet të merren pas një viti, ose kur parapagimi lidhet me një aset i cili në vetvete do të klasifikohet si afatgjatë me njohjen fillestare. Parapagimet për blerjen e aseteve transferohen në vlerën kontabël të asetit pasi Kompania të ketë marrë kontrollin e asetit dhe ka të ngjarë që përfitimet ekonomike të ardhshme të lidhura me asetin të rrjedhin në kompani. Parapagimet e tjera fshihen në fitim ose humbje kur merren mallrat ose shërbimet në lidhje me parapagimet. Nëse ka një tregues se asetet, mallrat ose shërbimet në lidhje me një parapagim nuk do të merren, vlera kontabël e parapagimit shënohet në përputhje me rrethanat dhe një humbje korresponduese nga dëmtimi njihet në fitim ose humbje për vitin.

Kapitali aksionar. Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

Stoqet. Stoqet maten me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e stoqeve bazohet në metodën specifike të identifikimit dhe përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e konvertimit dhe kostot e tjera të shkaktuara për sjelljen e stoqeve në vendndodhjen dhe gjendjen e tyre aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën e zakonshme të biznesit, minus kostot e vlerësuarat të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

Prona, impiantet dhe pajisjet. Prona, impiantet dhe pajisjet paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe minus humbjet nga dëmtimi, nëse ka. Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së artikujve. Kostot e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të aseteve ose njihen si një aset i veçantë, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme të lidhura me zërin do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet tjera dhe mirëmbajtja njihen në fitim ose humbje kur ndodhin. Kur pjesë të një zëri të pasurive afatgjata kanë jetëgjatësi të ndryshme të dobishme, ato llogariten si zëra të veçantë të pasurive afatgjata. Në çdo fund të çdo date raportimi, menaxhmenti vlerëson nëse ka ndonjë tregues për dëmtim të pasurive afatgjata.

Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si më e larta midis vlerës së drejtë të një aseti minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Vlera kontabël reduktohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga rënia në vlerë (dëmtimi) njihet në fitim ose humbje për vitin në masën që tejkalon tepriçën e mëparshme të rivlerësimit në ekuitet.

Zhvlerësimi i zërave të pasurive afatgjata, llogaritet mbi bazën lineare për të shlyer koston e çdo zëri të pasurive afatgjata në vlerën e mbetur gjatë jetës së tij të dobishme të vlerësuar. Toka nuk amortizohet. Asetet plotësisht të zhvlersuara mbahen në kontabilitet derisa të mos jenë më në përdorim dhe nuk ngarkohet zhvlerësim tjetër në lidhje me këto asete. Investimet në vijim nuk zhvlerësohen pasi asetet nuk janë ende plotësisht të instaluar dhe të disponueshme për përdorim.

KRU GJAKOVA SH.A.

Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

Jetëgjatësia e dobishme e vlerësuar e pronave, makinerive dhe pajisjeve është si më poshtë:

Tokat	Toka nuk zhvlerësohet
Objektet ndërtimore	30-100 vite
Rrjeta e ujësjellësit	30-40 vite
Lidhjet shtëpiake	20-30 vite
Ujëmatësit	10-32 vite
Paisjet e makinerisë	6-10 vite
Paisjet e mirëmbajtjes	10 vite
Automjetet	10-14 vite
Paisjet e TI	10-15 vite
Paisjet e zyreve	10-15 vite

Vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e vlerësuar e aseteve rishikohet, dhe nëse është e nevojshme, rregullohet në çdo datë të Pasqyrës së pozicionit financiar. Kur vlera kontabël e një aseti është më e madhe se shumata e vlerësuar e rikuperueshme e tij, ajo shënohet menjëherë në shumën e rikuperueshme të tij.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël dhe njihen neto brenda të ardhurave/shpenzimeve të tjera operative në fitim ose humbje.

Lizingu operativ. Asetet që i nënshtrohen lizingut operativ paraqiten në pasqyrat financiare sipas natyrës së asetit. Të ardhurat nga qiraja prej lizingut operativ njihen në fitim ose humbje mbi bazën lineare gjatë afatit të qirasë, përveç rastit kur një bazë tjetër sistematike është më përfaqësuese e modelit kohor në të cilin përdorimi ose përfitimi që rrjedh nga aseti i dhënë me qira zvogëlohet. Kostot, duke përfshirë zhvlerësimin, të shkaktuara në fitimin e të ardhurave nga qiraja njihen si shpenzim.

Provizionet. Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Kompania ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv (i tërthortë) që mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe ka të ngjarë që do të kërkojë një dalje e përfitimeve ekonomike për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar rrjedhjet e ardhshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për detyrimin. Zhdukja e skontimit njihet si kosto financiare.

Njohja e të hyrave. Të hyrat njihen në një mënyrë që përshkruan modelin e transferimit të mallrave dhe shërbimeve tek klientët. Shumata e njohur pasqyron shumën për të cilën Kompania pret të ketë të drejtë në këmbim të këtyre mallrave dhe shërbimeve.

Një vlerësim i kohës së njohjes së të ardhurave bëhet për çdo detyrim të performancës. Të ardhurat njihen në një moment kohor për të gjitha transaksionet e të ardhurave ku kontrolli i mallrave të ofruara i transferohet klientit.

Të ardhurat njihen në masën që ka të ngjarë që përfitimet ekonomike të rrjedhin në kompani dhe të ardhurat mund të maten me besueshmëri, pavarësisht se kur bëhet pagesa. Kompania vlerëson marrëveshjet e saj të të ardhurave në bazë të kriterëve specifike në mënyrë që të përcaktojë nëse ajo është duke vepruar si parim apo agjent. Transaksionet pa mjete monetare janë përjashtuar nga pasqyra e rrjedhës së parasë. Aktivitetet investuese dhe financuese dhe totali i aktiviteteve operative përfaqësojnë rrjedhjet aktuale të parasë.

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi në bilancet me bankat. Të ardhurat nga interesi njihen ashtu siç rrjedhin, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huamarrjet. Kostot e huamarrjes që nuk i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, ndërtimit ose prodhimit të një aseti të kualifikuar njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv.

KRU GJAKOVA SH.A.

Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

Fitimet dhe humbjet në valutë të huaj raportohen mbi një bazë neto si të ardhura financiare ose si kosto financiare, në varësi të faktit nëse lëvizjet e valutës së huaj janë në një pozicion fitimi neto ose humbje neto.

Përfitimet e Punonjësve

(i) Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore

Kompania jep vetëm kontribute në planin e pensioneve të administruar publikisht. Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), siç kërkohet me ligj. Kompania nuk ka detyrime të tjera pagese pasi të jenë paguar kontributet. Kontributet njihen si shpenzime për përfitimet e punonjësve kur ato duhet të paguhen. Kompania nuk ka asnjë detyrim të mëtejshëm ndaj punonjësve të saj përtej këtyre kontributeve.

(ii) Pushimi vjetor me pagesë

Kompania njih si detyrim shumë të paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me pushimin vjetor që pritet të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat. Tatimi aktual mbi të ardhurat llogaritet bazuar në rregulloret e tatimit mbi të ardhurat në fuqi në Kosovë, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit.

Shkalla e tatimit mbi të ardhurat e korporatave është vendosur në 10% në përputhje me rregulloret tatimore të Kosovës aktualisht në fuqi, Ligji nr. 06/L-105 "Për tatimin në të ardhura e korporatave". Tatimi mbi të ardhurat në fitim ose humbje për vitin përfshin tatimin aktual dhe ndryshimet në tatimin e shtyrë. Tatimi aktual llogaritet në bazë të fitimit të pritshëm të tatueshëm për vitin duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në fitim ose humbje sepse përjashton zërat e të ardhurave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vite të tjera dhe më tej përjashton zërat që nuk janë kurrë të tatueshme ose të zbritshëm. Tatimet e tjera përveç taksave mbi të ardhurat regjistrohen në shpenzimet operative.

Tatimi i shtyrë mbi të ardhurat llogaritet duke përdorur metodën e detyrimit të bilancit të gjëndjes për të gjitha diferencat e përkohshme që lindin ndërmjet bazës tatimore të pasurive dhe detyrimeve dhe vlerës së tyre kontabël për qëllime të raportimit financiar.

Pasuritë dhe detyrimet nga të ardhurat e shtyra tatimore maten me normat tatimore që pritet të zbatohen në periudhën kur pasuria është realizuar ose detyrimi është shlyer, bazuar në normat tatimore (dhe ligjet tatimore) që janë miratuar në datën e raportimit.

Pasuritë dhe detyrimet e shtyra të tatimit mbi të ardhurat kompensohen kur ekziston një e drejtë e zbatueshme ligjrisht për të kompensuar pasuritë tatimore korrente kundrejt detyrimeve tatimore korrente dhe kur ekziston synimi për të vendosur bilancet në një bazë neto.

IV. Vlerësimet dhe supozimet kritike të kontabilitetit

Kompania bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe në vlerat kontabël të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e menaxhmentit dhe në faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme sipas rrethanave. Menaxhmenti gjithashtu bën disa gjykime, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim të rëndësishëm në vlerën kontabël të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

KRU GJAKOVA SH.A.

Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

Jetëgjatësia e dobishme e asetëve. Përcaktimi i jetëgjatësisë së dobishme të asetëve bazohet në përvojën historike me asete të ngjashme, si dhe në çdo zhvillim të pritshëm teknologjik dhe ndryshime në faktorët e gjerë ekonomikë ose të industrisë. Përshtatshmëria e jetëgjatësisë së dobishme të vlerësuar rishikohet çdo vit, ose sa herë që ka një tregues të ndryshimeve të rëndësishme në supozimet bazë. Më tej, për shkak të peshës së konsiderueshme të asetëve të amortizueshme në totalin e asetëve të Kompanisë, ndikimi i çdo ndryshimi në këto supozime mund të jetë material për pasqyrat financiare dhe të ndikojë në pozicionin financiar dhe në rezultatet e operacioneve të Kompanisë.

Dëmtimi i mundshëm i pronave, objekteve dhe pajisjeve. Kompania vlerëson dëmtimin e pasurive afatgjata materiale të identifikueshme sa herë që ka një arsye për të besuar se vlera kontabël mund të tejkalojë materialisht shumën e rikuperueshme dhe kur parashikohet dëmtimi në vlerë. Shumat e rikuperueshme përcaktohen nga llogaritjet e vlerës në përdorim, të cilat përdorin një gamë të gjerë vlerësimesh dhe faktorësh që ndikojnë në to. Ndër të tjera, Kompania zakonisht merr në konsideratë të ardhurat dhe shpenzimet e ardhshme, vjetërsimin teknologjik, ndërprerjen e operacioneve dhe ndryshime të tjera në rrethana që mund të tregojnë dëmtim. Nëse dëmtimi identifikohet duke përdorur llogaritjet e vlerës në përdorim, përcaktohet gjithashtu vlera e drejtë minus kosto e shitjes, për të llogaritur shumën e saktë të dëmtimit që do të ngarkohet (nëse ka).

Vlerësimi i llogarive të arkëtueshme. Kompania llogaritë zhvlerësimin për llogaritë e dyshimta bazuar në humbjet e vlerësuar si pasojë e pamundësisë së klienteve tanë për të bërë pagesat e kërkuara. Sipas politikave të kompanisë, faktorët e mëposhtëm merren në konsideratë gjatë vlerësimit të zhvlerësimit të të arkëtueshmeve: pagesa të shpeshta me vonesë, klientë me rrezik të lartë dhe klientë me vështirësi financiare, me përjashtim të tregtarëve me shumicë dhe partnerëve të lidhur. Këta faktorë rishikohen në menyrë periodike dhe bëhen ndryshime në llogaritjet kur është e nevojshme. Vlerësimet përfshijnë supozimet në lidhje me sjelljen e konsumatorëve të ardhshëm dhe arkëtimet e parasë në të ardhmen. Nëse gjëndja financiare e klientëve tanë do të përkeqësohej, zhvlerësimi aktual i të arkëtueshmeve ekzistuese mund të jetë më i lartë se sa pritej dhe mund të tejkaloj nivelin e humbjeve nga zhvlerësimi të njohura deri më tani.

KRU GJAKOVA SH.A.

Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

1. Prona, impiantet dhe pajisjet

	Toka	Ndërtesa	Pajisjet dhe Inventari	Investimet në vijim	Gjithsej
<i>Kosto Historike</i>					
Me 31 dhjetor 2018	9,897,509	13,701,386	28,299,649	948,844	52,847,388
Blerjet	-	806	531,644	6,134,676	6,667,126
Rregullimet	-	-	-	-	-
Me 31 dhjetor 2019	9,897,509	13,702,192	28,831,293	7,083,520	59,514,514
Blerjet	-	1,418	331,982	1,275,033	1,608,433
Me 31 gusht 2020	9,897,509	13,703,609	29,163,275	8,358,553	61,122,947
Blerjet	-	179,499	2,297,320	-	2,476,819
Hegjet	-	(7,124,812)	(13,827,129)	(2,177,238)	(23,129,179)
Shuma e rivlerësuar me 31 gusht 2020	2,082,191	5,316,083	3,855,815	-	11,254,089
Me 31 dhjetor 2020	11,979,700	19,199,191	35,316,411	6,181,316	51,724,676
Blerjet	-	42,663	281,363	988,020	1,312,046
Rregullimet	-	-	(2,871)	-	(2,871)
Hegjet	-	-	-	-	0
Me 31 dhjetor 2021	11,979,700	19,241,853	35,594,903	7,169,336	53,033,850
Blerjet	-	7,998	697,675	1,317,240	2,022,913
Rregullimet	-	-	(11,532)	-	(11,532)
Hegjet	-	-	-	(229,015)	(229,015)
Me 31 dhjetor 2022	11,979,700	19,249,852	36,281,045	8,257,560	54,816,216
Blerjet	-	4,786,666	11,956,550	8,174,160	24,917,376
Rregullimet	-	-	-	-	0
Hegjet	-	-	-	(15,736,561)	(15,736,561)
Me 31 dhjetor 2023	11,979,700	24,036,517	48,237,596	695,160	63,997,031
<i>Zhvlerësimi i Akumuluar</i>					
Me 31 Dhjetor 2019	-	(7,124,812)	(13,827,130)	-	(20,951,942)
Zhvlersimi I vitit	-	(351,764)	(1,505,601)	-	(1,857,365)
Me 31 dhjetor 2020	-	(351,764)	(1,505,601)	-	(1,857,365)
Zhvlersimi I vitit	-	(351,923)	(1,489,350)	-	(1,841,272)
Me 31 dhjetor 2021	-	(703,686)	(2,994,951)	-	(3,698,637)
Zhvlersimi I vitit	-	(353,716)	(1,501,488)	-	(1,855,204)
Me 31 Dhjetor 2022	-	(1,057,402)	(4,496,439)	-	(5,553,842)
Zhvlersimi I vitit	-	(391,505)	(1,586,410)	-	(1,977,915)
Rregullimet ne Zhvlersimin e akumuluar	-	-	10,092	-	10,092
Me 31 Dhjetor 2023	-	(1,448,907)	(6,072,757)	-	(7,521,664)
<i>VNL</i>					
Me 31 dhjetor 2019	9,897,509	6,577,380	15,004,163	7,083,520	38,562,572
Me 31 dhjetor 2020	11,979,700	18,847,427	33,810,809	6,181,316	49,867,311
Me 31 dhjetor 2021	11,979,700	11,413,355	32,599,951	7,169,336	49,335,213
Me 31 dhjetor 2022	11,979,700	18,192,449	31,784,606	8,257,560	49,262,374
Me 31 dhjetor 2023	11,979,700	22,587,610	42,164,839	695,160	56,475,367

KRU GJAKOVA SH.A.**Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023****2. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera**

Më 31 dhjetor	2023	2022
Të arkëtueshmet tregtare rezidenciale	7,034,584.41	7,252,868
Të arkëtueshmet - komerciale	2,452,357.93	2,467,783
Të arkëtueshme tjera dhe parapagime	102,048.93	145,541
Tatimi i parapaguar	59,235.56	96,229
Gjithsej	9,648,227	9,962,421
Provizionet	(4,080,594)	(3,985,725)
Gjithsej neto	5,567,632	5,976,696

Lëvizja në llogarinë e provizioneve

	2023	2022
Ngarkesa për vitin	94,869.42	97,207
Hegja për vitin/e njohur në të ardhura		
Me 31 dhjetor	94869.42	97,207

3. Stoqet

Më 31 dhjetor	2023	2022
Kemikalet	26,890.97	21,538
Materiali për gypsjellesa	561,636	565,913
Ujmatesit	63,102	58,604
Material vegla harxhues	63,009	15,759
Material vegla pune	7,038	5,871
Material mbrojtja në punë	1,538	1,371
Material elektrik	6,363	6,459
Material administrativ	5,221	5,404
Material për pastrim	599	860
Vajrat	1	47
Material për automjete	537	336
Gjithsej	735,934.92	682,161

4. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Më 31 dhjetor	2023	2022
Paraja në arkë	-	-
ProCredit Banka	36,857	12,277
ProCredit Banka-Donacionet	496,496	713,386
Banka Ekonomike	136,758	5,002
NLB Banka	68,467	69,855
Raiffeisen Banka	48,999	39,504
TEB Banka	819	2,796
TEB POS	14,985	173
Banka Kombetare Tregtare-Rrjedhese	9,673	116,528
Banka Kombetare Tregtare-Giro	4,816	3,150
Banka Kombetare Tregtare-Donacionet	-	1,023
Banka për Biznes	359,461.16	538,640
Gjithsej	1,177,330.59	1,502,335

KRU GJAKOVA SH.A.**Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023****5. Kapitali Aksionar**

Më 31 dhjetor	2023	2022
Kapitali Aksionar	25,000.00	25,000
Gjithsej	25,000.00	306,960

6. Fitimi/Humbja e bartur

Më 31 dhjetor	2023	2022
Humbja gjatë viteve	2,475,314	2,186,777
Fitimi	1,995,599	1,995,599
Humbja/Fitimi i vitit	-266,064	-
Gjithsej	- 745,779	- 479,714.50

7. Rezerva e rivleresimit

Më 31 dhjetor	2023	2022
Rezerva e rivleresimit	40,881,214	41,043,598
Rezervat tjera	29,750	-
Gjithsej	40,910,964	41,043,598.18

8. Llogarit e paguara dhe te tjerat

Më 31 dhjetor	2023	2022
Të pagueshmet ndaj furnitorëve	214,243.30	244,737
Të pagueshme TVSH	-9,921.32	26,290
Gjithsej	204,321.98	271,027

9. Detyrimet ndaj punetoreve dhe tatimet

Më 31 dhjetor	2023	2022
Të pagueshmet ndaj punonjësve	0.00	1,056
Tatimi në burim i pagueshëm	18,704.82	15,092
Kontributi pensional i pagueshëm	26,852.24	22,844
Të pagueshme për detyrimet tatimor	657.74	379
Detyrime ndaj tatimit në fitim	25,609.22	47,306
Gjithsej	71,824.02	86,677

10. Te hyrat e shtyera

Më 31 dhjetor	2023	2022
Të hyrat e shtyra	23,489,933	16,476,979
Gjithsej	23,489,933	16,476,979

Lëvizja e të hyrave të shtyra

	2023	2022
Me 1 janar	16,476,979	15,991,730
Të shtyra gjatë vitit	8,056,880	1,065,912
Të njohura në pasqyrën e të ardhurave	(1,043,926)	(580,663)
Me 31 dhjetor	23,489,933	16,476,979

KRU GJAKOVA SH.A.**Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023****11. Të hyrat**

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor	2023	2022
Të hyrat-konsumatorë rezidencaill	3,733,665.30	3,702,555
Të hyrat-konsumatorë komercial	973,575.44	1,173,510
Të hyrat tjera	172,810.79	172,996
Të hyra nga donacionet	1,043,925.86	580,663
Gjithsej	5,923,977.39	5,629,725

12. Shpenzimet e personelit

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor	2023	2022
Shpenzime për pagat dhe shpërblimet	2,604,680.06	2,473,734
Shpenzimet për pensione 5%	130,224.36	123,912
Gjithsej	2,734,904.42	2,597,646

13. Shpenzimet operative dhe administrative

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor	2023	2022
Shpenzimet e Reklamës	6,287	8,300
Shpenzimet e Energjisë Elektrike	425,818	364,337
Shpenzimet e Karburantëve	105,085	119,189
Shpenzimet e Zyrës	0	0
Shpenzimet e Qerasë	34,714	36,240
Shpenzimet e Lejeve dhe Licencave	105,902	85,714
Shpenzimet e Telefonit dhe Internetit	16,981	17,925
Shpenzimet e Mirmbajtjes /Servisimit	102,617	137,609
Shpenzimet Komunale	46,195	293,191
Shpenzimet Administrative	15,410	14,858
Shpenzimet të shitjes	1,635	32,460
Shpenzimet të tjera	521,709	258,332
Shpenzimet e lejlmeve per llogari te arketueshme	94,869	97,207
Shpenzimet të borxhit keq	0	50
Gjithsej	1,477,223	1,465,411

14. Shpenzimet e zhvleresimit

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor	2023	2022
Zhvleresimi i vitit	1,977,914.56	1,855,204
Gjithsej	1,977,914.56	1,855,204.30

KRU GJAKOVA SH.A.

Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

V. Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Menaxhmenti i Kompanisë konsideron se vlerat kontabël të aseteve financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara me kosto ose kosto të amortizuara në pasqyrat financiare ngjajnë me vlerën e tyre reale për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër.

Menaxhimi i rrezikut

Aktivitetet e Kompanisë e ekspozojnë atë në një shumëllojshmëri të rreziqeve financiare, duke përfshirë:

- (a) rreziku kapital
- (b) rreziku kreditor
- (c) rreziku i likuditetit
- (d) rreziku i tregut

Ky shenim paraqet informacion rreth ekspozimit të Kompanisë ndaj secilit prej rreziqeve të mesiperme, objektivat, politikat dhe proceset e Kompanisë për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit.

Korniza e menaxhimit të rrezikut

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Kompanisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Kompania, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Kompania, përmes standardeve dhe procedurave të menaxhimit synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre. Drejtimi kryen monitorimin e përditshëm për të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurat dhe shpenzimet, duke zbatuar praktikatat me të mira.

Menaxhimi i Rrezikut kapital

Objektivat e kompanisë kur menaxhojnë kapitalin janë:

- të ruajnë aftësinë e tyre për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë së biznesit, në mënyrë që ata të mund të vazhdojnë të ofrojnë kthime për aksionarët dhe përfitimet për palët e tjera të interesuara, dhe
- të mbajë një strukturë optimale të kapitalit për të ulur koston e kapitalit.

Rreziku i kredisë

Rreziku i mos - pagesës ekziston kur pala tjetër nuk mund të përmbushë detyrimet e saj për të paguar llogaritë e arkëtueshme të Kompanisë. Rreziku maksimal i kredisë për instrumentet financiare jo-derivative është teorikisht e barabartë me vlerën e drejtë të të gjitha llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve ndaj debitorit të njëjtë kur kompensimi është i lejuar.

Më 31 dhjetor	2023	2022
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	1,177,331	1,502,335
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera	5,567,632	5,976,696
Gjithsej	6,744,963	7,479,031

KRU GJAKOVA SH.A.

Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që një njësi ekonomike do të ndeshë vështirësi në plotësimin e detyrimeve që lidhen me detyrimet financiare që duhet të shlyhen nëpërmjet lëvrimin të mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Pikepamja e Kompanisë për menaxhimin e likuiditetit është për të siguruar, aq sa është e mundur, që ajo do të ketë gjithmone likuiditet të mjaftueshem për të përmbushur detyrimet e saj në kohën e duhur, si në kushte normale dhe në kushte të renda, pa shkaktuar humbje të papranueshme ose rrezikun e demtimit të reputacionit të Kompanisë.

Më 31 dhjetor	2023	2022
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	1,177,331	1,502,335
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera	5,567,632	5,976,696
Gjithsej	6,744,963	7,479,031
Llogaritë e pagushme dhe te tjera	204,322	271,027
Detyrimet ndaj punetoreve dhe tatimet	71,824	86,677
Gjithsej	276,146	357,704
Hapësira e likuiditetit	6,468,817	7,121,327

Rreziku i Tregut

Rreziku i tregut është rreziku i ndryshimit të cmimeve të tregut, sic janë kurset e kembimit, normat e interesit dhe cmimet e kapitalit që do të ndikojnë të ardhurat e Shoqërisë ose vlerën e instrumenteve financiare që mban ai. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është për të menaxhuar dhe kontrolluar ekspozimet e rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshem, duke optimizuar kthimin.

a) Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të kembimit

Kjo është një formë e rrezikut që rrjedh nga ndryshimi i cmimit të një monedhe kundrejt një tjetre. Rreziku i monedhes është menaxhuar duke monitoruar pozicionet e hapura valutore. Rreziku i monedhes menaxhohet duke përdorur parimet e përputhjes aktive/detyrime dhe përmes kontributeve të pronareve. Kompania operon kryesisht në Euro.

15. Palët e lidhura

Kompania nuk ka hyrë në transaksione me palët e lidhura gjatë vitit 2023

16. Zotimet

Më 31 dhjetor 2023, Kompania nuk ka pasur zotime.

17. Detyrimet kontingjente

Gjatë komunikimit me departamentin Juridik kemi pranuar rastet gjyqësore që ka Kompania dhe janë raste apo detyrime të cilat do të ndodhin në të ardhmen. D.m.th. janë detyrime apo obligime të cilat nuk dihet sakt se kur do të ndodhin, pasi që varen nga proceset Gjyqësore të cilat kanë vonesa, dhe për këtë arsye do ti njohim vetëm si detyrime kontingjente dhe si të tilla vetëm do ti shpalosim.

Vlera totale e kontesteve ku Kompania është palë e paditur është 167,958 Euro

KRU GJAKOVA SH.A.

Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

Janë raste Gjyqesore të natyrave të ndryshme si: konteste të punës, poashtu konteste për kompensim dami. Të gjitha janë të natyrave të procedures civile.

Këto shpenzime presim të ndodhin në të ardhmen, mund të ndodhin nga vitit 2024 e tutje. Vlera totale financiare e këtyre kontesteve të cekura më lart mund të ndryshojë për shumë arsye: shpenzimet e procedures gjyqësore, kamat vonesat dhe ekspertizat e ndryshme, andaj të gjitha këto raste do të vendosen në bazë të Aktgjykimit- Aktvendimit të Gjykatave të shtetit. Këto raste janë të pa sigurta për kohën e ndodhjes pasi në bazë të përvojës procedurat gjyqësore vonohen. Procedurën e vonon zakonisht ekspertiza nga ekspertët e caktuar nga Gjykata, si dhe përdorimi i mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

18. Ngjarjet pasuese

Nuk ka ngjarje pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar që kërkon korrigjime ose shpalosje në pasqyrat financiare.

19. Aprovimi i pasqyrave financiare

Pasqyra financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar për publikim me date 09.02.2024.